



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 1281

NR. VENDIMI 799



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

*Nr.1281 Akti
Vendimi
Dt.Regj 14.12.2015
Dt. 16.03.2016*

Nr. 799

V E N D I M

"Ne emer te Republikes"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e perbere nga

GJYQTARI : Bedri QORI

Asistuar nga sekretarja *Valtida Ribaj* dhe me pjesemarrjen e prokurorit ***, sot ne Tirane, me 16.03.2016 mori ne shqyrtim çeshtjen penale qe i perket :

I D E M T U A R A K U Z U E S: ***, *i biri i *** dhe i ****, dtl. ***, *lindur dhe banues ne ****, *me arsim te larte, i padenuar me pare, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, përfaqësuar nga Av. ***me nr. liçence ***.*

I A K U Z U A R I : ***, *i biri i *** dhe i ****, *i datëlindjes ****, *lindur dhe banues ne ****, *me arsim te larte, i padenuar me pare, i perfaqesuar nga av. ***.*

A K U Z U A R: Per kryerjen e vepres penale "*Riprodhimit pa te drejte te vepres se tjetrit*".

B A Z A L I G J O R E: Neni *149 i K.Penal.*

Ne diskutimin perfundimtar palet kerkuan :

I demtuari akuzues kerkoi pranimin e kerkeses, deklarimin fajtor te te akuzuarit per vepren penale te riprodhimit pa te drejte te vepres se tjetrit dhe denimin e tij me *** (***) vit burgim.

*Perfaqesuesi i i te akuzuarit ****, kerkoi rrezimin e kerkeses se te demtuarit akuzues dhe deklarimin e pafajshem te te akuzuarit ***.

Prokurori kerkoi rrezimin e kerkeses se bere nga kerkuesi *** si te pabazuar ne prova e ne ligj.

Gjykata pasi degjoi pretendimet e paleve, shqyrtoi provat dhe ceshtjen ne teresi.

VEREN

Se i demtuari akuzues *** i eshte drejtuar Gjykates duke kerkuar gjykimin e te akuzuarit ***, duke e akuzuar ate se ka kryer vepren penale te "Riprodhimit pa te drejte te vepres se tjetrit" te parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal.

Meqenese ceshtja nuk u arrit te zgjidhej me pajtim, bazuar ne nenin 338 te K.Pr.Penale Gjykata vendosi qe ceshtja te kaloje per gjykim duke njoftuar dhe siguruar edhe pjesmarjen e perfaqesuesit te organit te Prokurorise. Nga hetimi gjyqesor i zhvilluar ne seance gjyqesore rezultoi se :

A. Nga ana e te demtuarit akuzues * u pretendua se :**

I demtuari akuzues ***, eshte autor i veprës: "Videogram "20 shkurti, rënia e bustit të Enver Hoxhës", për të cilën mbështetur në Ligjin nr.9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të", si dhe VKM nr.232, datë 19.04.2006 "Për krijimin e funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit", e ka certifikuar regjistrimin e të drejtës së autorit për veprën në fushën: "Krijimet kinematografike dhe krijimet e tjera audiovizuale" me Certifikatën e Regjistrimit datë 31.10.2007.

Nga ana e shtetasit *** në kundërshtim me Ligjin nr.9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të", si dhe VKM nr.232, datë 19.04.2006 "Për krijimin e funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit", nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, më konkretisht në datën *** ora *** minuta, në faqen e tij personale në rrjetin social Facebook, me të dhënat e ***, *** ka publikuar një video me përshkrimin 'Fjalimi i Azem Hajdarit pas atentatit të parë në Parlament' me pamje nga rrëzimi i bustit të Enverit të realizuara nga z ***, pa lejën dhe miratimin e tij.

Në datën 07.12.2015 ora 14:00 në seancën gjyqësore që po zhvillohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë Dhoma Penale, shtetasi *** është legjitimuar si avokat mbrojtës i të pandehurit, personit juridik ***, në çështjen me nr *** regjistruar në datë *** me gjyqtare ***, ku *** bazuar në nenin 149 të Kodit Penal është në cilësinë e të demtuarit akuzues.

Sa më sipër, shtetasi ***, është në dijeni të plotë në lidhje me faktin që autorësinë e veprës e gëzon z. *** dhe me dashje në datën *** ora *** minuta poston pa lejë të autorit në profilin e tij në rrjetin social facebook pamjet "Videogram "20 shkurti, rënia e bustit të Enver Hoxhës". Më konkretisht, shtetasi ***, ka përfituar nëpërmjet cënimit të veprës së z. ***, duke transmetuar në facebook veprën e tjetrit, nëpërmjet postimit ka patur 4 mijë e 300 vizitorë, 240 pëlqime, 50 shpërndarje duke shkelur hapur dhe me vetëdije nenin 149 të Kodit Penal, si dhe duke cënuar rëndë veprën e autorit ***.

Në këtë mënyrë nga ana e këtij shtetasi është kryer vepra penale e parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal, ku konkretisht parashikohet: "Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i veprës letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, ose përdorimi i tyre pa pëlqim të autorit, kur kanë shkelur të drejtat vetjake e pasurore të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë. ose me burgim gjer në dy vjet".

Ky përdorim pa lejen time si autor, përbën veprën penale të kundërvajtjes të parashikuar në nenin 149 të Kodit Penal, pasi plotëson të gjitha elementët e kësaj vepre penale të parashtruar si më poshtë :

Objekt i kësaj kundërvajtje penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura në nenin 44 të Kushtetutës dhe në Ligjin nr.9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të", që kanë cënuar paprekshmërinë e së drejtës së autorit, të mbrojtura nga legjisllacioni penal, neni 149 i Kodit Penal.

Nga ana objektive, kjo kundërvatje penale: “Riprodhimi i veprës që i përket autorit ***, pa pëlqimin e tij”, është kryer nga shtetasi *** nëpërmjet postimit të veprës në faqen e tij *** në rrjetin social facebook, duke shkelur të drejtat e autorit personale dhe pasurore, të parashikuara në Ligjin nr.9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të”. Lidhur me këtë fakt, vetë i akuzuari në senacën e datës 07.03.2016 nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor pranoi faktin se në muajin janar të vitit 2016 policia e Pogradecit i ka marrë dhe sekuestruar laptopin e tij bashkë me materialet e ndodhura në të . Për sa i përket këtij fakti, mqj laptopi i shtetasit *** është marrë në muajin janar 2016, ky fakt nënkuton se nga ky muaj ky shtetas hipotetikusht nuk ka posedimin mbi këtë send, por në fakt, akuzat i përket muajit dhjetor 2015 dhe në këtë kuptim ky pretendim për tu shfaqësuar nga i akuzuar *** nuk qëndron.

Subjekt i kësaj kundërvatje penale është person madhor me zotësi të plotë për të vepruar dhe ka kryer veprën penale me qëllim për ta cënuar atë si dhe për të përfutuar prej saj. Në rastin konkret, rezulton se i akuzuari *** është madhor dhe i përgjegjshëm për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që kryen.

Nga ana subjektive, kjo kundërvatje penale është kryer me dashje të drejtpërdrejtë të personit ***, në dobi të tij, nëpërmjet veprimeve, ka publikuar një video me përshkrimin ‘Fjalimi i Azem Hajdarit pas atentatit të parë në Parlament’ me pamje nga rrëzimi i bustit të Enverit të realizuara nga z ***.

Në këtë mënyrë, bazuar edhe në Ligjin nr.9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të” neni 4 pika 38 parashikon se: “Riprodhimi i një vepre” nënkupton fiksimin e veprës origjinale në një mbajtës, për t’u përcjellë në publik”, shkak ky i provuar nga ana ime si i dëmtuar akuzues kundrejt shtetasit ***.

Gjithashtu, në mbështetje të nenit 10 të këtij Ligji parashikohen edhe të drejtat vetjake jo pasurore të autorit në rastin konkret të drejtat vetjake jopasurore që më takojnë mua si i dëmtuar akuzues, të cilat janë:

a) të vendosë nëse, në ç’ mënyrë dhe kur vepra e tij do t’i paraqitet publikut, si dhe vendin ku vepra e tij do të paraqitet për herë të parë në publik;

ç) të kërkojë respektimin e tërësisë së veprës dhe të kundërshtojë çdo heqje ose ndryshim, që cenon nderin dhe emrin e tij;

14. Gjithashtu në nenin 12 parashikohen të drejtat pasurore të autorit si:

a. Autori gëzon të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të veprës së vet në çdo formë dhe mënyrë.

b. Autori i një vepre letrare, artistike ose shkencore gëzon të drejtën e shpërblimit për çdo rast dhe për çdo mënyrë shfrytëzimi të veprës, të lejuar apo jo nga vetë ai, edhe nëse heq dorë nga kjo e drejte.

15. Ndërsa neni 13 pika ‘a’ e po këtij ligji, parashikon se : “Autori gëzon të drejtën ekskluzive, duke pasur parasysh veprën e vet, në tërësi ose pjesërisht, për të autorizuar:

a) riprodhimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të përkohshëm ose të përhershëm me çfarëdo lloj mjete apo forme”.

16. Fajësia e të akuzuarit personit *** për kryerjen e veprës penale në dobi të tij nga organet dhe përfaqësuesit e tij, për kryerjen e kundërvatjes penale të parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal, si dhe detyrimi për dëmin e shkaktuar provohet nga:

Çertifikatë regjistrimi ***, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit

Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Nr *** Vendimi datë ***

Kontratë Autorizimi, Nr. *** Prot, datë ***

Ekstrakt i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale Nr ***CD (me regjistrim)

Fotografi 2 copë (të cilat kanë fiksuar momentin rënies së bustit, të transmetuar e shpërndarë nga shtetasi ***)

Vetë pohimi i përfaqësuesit ligjor kur shprehet se laptopi me të cilin është shpërndarë ky

material i është sekuestruar nga policia (pavarësisht se ky fakt nuk ka rëndësi, pasi nuk u soll para gjykatës asnjë provë nga i akuzuari se këtë kompjuter ia kanë sekuestruar sikurse pretendon)

Ne kete menyre, sipas te demtuarit akuzues, ky subjekt ka kryer vepren penale te parashikuar nga neni 149 i K.Penal.

B. Nga ana e perfaqesuesit te te akuzuarit ***, u kerkua rrezimi i kerkeses dhe pagimin e shpenzimeve ne ngarkim te kerkuesit, pasi nuk arriti per asnjë moment të provonte gjatë hetimit gjyqësor pretendimet e tij, nuk rezultoi të kishte legjitimitet aktiv dhe kishte sjellë në gjykim prova jo në formën e kërkuar nga ligji si edhe pretendime jo të bazuara në ligj, përfundimisht kërkojmë rrëzimin e kërkesës dhe shpenzimet gjyqësore procedurale dhe avokatore në ngarkim të palës kërkuese ***, duke pretenduar se :

Prova CD-Audio Rregjistrim pamje filmike e cila nuk ishte në formën e kërkuar nga ligji konkretisht sipas neneve 119, 187, 188 dhe 191 të Kodit Procedurës Penale si edhe sipas Vendimit Unifikues Nr 1 dt 27.04.2015 të Gjykatës së Lartë;

*Prova CD-Audio Rregjistrim pamje filmike pretendohej që ishte marrë nga faqja zyrtare në rrjetin social "facebook" të shtetasit ***, por që kjo gjë rezultoi që nuk ishte e vertetë sepse ajo nuk ishte një faqe zyrtare e në rrjetin social facebook e shtetasit *** dhe duke theksuar faktin që gjatë hetimit gjyqësor nuk u provua dot nga pala kërkuese që shtetasi *** të kishte ndonjë faqe zyrtare në këtë rrjet social. Por vetë nga shtetasi *** u pohua që është bashkë administrator i disa faqeve të tjera në rrjetin social "facebook". Aq më tepër që me emrin shtetasit *** në këtë rrjet social gjendeshin mbi dhjetra deri në qindra profile apo faqe të hapura nën emrin e tij dhe ishte shumë e vështirë të provohej vërtetësia e këtyre faqeve kur nuk dihej se kush i kishte hapur e kush i administronte. Për më tepër gjatë hetimit gjyqësor, vetë shtetasi *** pohoi që në Janar të 2015 Policia e Shtetit në Pogradec i kishte marrë laptopin dhe celularin e tij duke ndërhyrë në të gjithë të dhënat e tij të transmetimit online, duke i klonuar fjalë-kalimet dhe ky fakt provohej lehtësisht nga një fakt tjetër publik sic ishte deklarata për shtyp e kësaj policie por edhe nga deklaratimet e kryera në atë kohë nga shtetasi *** pranë stacionit të këtij komisariati në Pogradec në lidhje me marrjen e fjalë-kalimeve dhe kontrollin e celularit të tij pa vendim të gjykatës dhe prokurorisë. Që do të thotë që siguria kompjuterike në profilet e pretenduara të shtetasit *** tashmë që prej asaj periudhe e deri më sot ishte ulur maksimalisht dhe ky shtetas nuk është posedues i fjalë-kalimeve të faqeve në këtë rrjet social për faqen që pretendohej nga kërkuesi që mund të ishte faqja zyrtare e shtetasit *** por që ky u fundit pranoi që ishte bashkë-administrator në disa profile dhe faqe tjera;*

*Që një faqe apo profil të jetë zyrtar në këtë rrjet social pra, edhe i njohur nga ky rrjet social duhet që profili apo faqja në këtë rrjet të ketë anash emrit një si ETIKETË BLU me shenjën ?. Për këtë arsye faqja që pretendon kërkuesi që është faqja zyrtare e shtetasit *** nuk rezultoi të ishte e vërtetë sipas pretendimit të kërkuetit sepse ky shtetas nuk ka asnjë faqe zyrtare;*

*CD-Audio Regjistrimi pamje filmike të sjella nën cilësinë e provës nga kërkuesi edhe pse jo në formën e kërkuar nga ligji nga përmbajtja e saj filmike dallohej qartë që mbante LOGON e institutit *** dhe jo të kërkuetit ***. Pra, edhe sikur të ishim në kushtet që gjithcka më sipër të ishte e vërtetë dhe marrja e provave do të ishte sipas formës kërkuar nga ligji, përmbajtja e këtij rregjistrimi nuk ka lidhje me shtetasin *** përse kohë ky është një regjistrim me përmbajtje me institutin italian ***. Pra, do të ishte instituti *** që do të mund të ngrinte pretendime ndaj shtetasit *** dhe jo kërkuesi ***. Kërkuesi *** këto pretendime mbi të drejtën e autorisë mund t'i ngrite vetëm ndaj institutit ***.*

*2 faqet fotokopje të sjella në gjykim nën cilësinë e provës të marra nga faqja e Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë e të firmosura nga Av. *** nuk përmbënin provë në kuptim të*

ligjit dhe nuk rezultuan të ishin në formën e kërkuar nga ligji sepse Avokati nuk mund të jetë noter publik apo punonjës gjykatë që njehson aktet me origjinalet. Pretendimin i përfaqësuesit të kërkuarit mbi marrjen e dijensës së shtetasit *** në një gjykim tjetër ku shtetasi *** ka qenë nën cilësinë e avokatit jo vetëm që nuk është e mbështetur në prova por edhe është e pavërtetë. Kërkuar dhe përfaqësuesi duhet të provonin këtë fakt me prova konkrete dhe jo thashetheme apo fjalë të pabazuara në prova.

Në këtë gjykim, kërkuar *** rezultoi të mos kishte legjitimitet aktiv për ngritjen e kësaj kërkesë duke qenë se CD-Audio Regjistrim pamje filmike përmbante logon e institutit italian *** i cili është një institut i mirënjohur ndërkombëtar shumë serioz dhe që nuk ka si praktikë të punës së tij piraterimin e të drejtave të autorit dhe që këto të drejta në faqen zyrtare të saj i lejon të transmetohen falas për qëllime publike dhe informimi. Pra, i vetmi kërkuar që do të mund të depozitonte këtë kërkesë për gjykim ndaj shtetasit *** duhej të ishte instituti italian *** dhe jo kërkuar ***.

Sa i përket faktit nëse shtetasi *** i ka përdorur këto imazhe që pretendohen sikur janë të shtetasit *** sic rezultoi gjatë hetimit gjyqësor këto imazhe ishin marrë nga instituti *** dhe asnjë herë shtetasi *** nuk kishte informuar publikisht, zyrtarisht apo qoftë edhe në mënyrë informale shtetasin *** që vetë *** ka qenë posedues i kësaj të drejte e t'a paralajmëronte për mos përdorimin e saj. Kujtojmë që veprimi për të paralajmëruar apo njoftuar personin që përdor një vepër të tjetrit është një detyrim ligjor i kujtdo që pretendon se ka të drejta të certifikuar mbi një regjistrim sepse e kundërta do të konsiderohej një kurth, grackë që shtetasit që pretendojnë këto të drejta do t'i bënin subjekteve të ndryshme të shumtë fizik apo juridik apo qoftë edhe qytetarëve të ndryshëm. Por jo vetëm kaq, por që këto janë kërkesat minimale të kërkuara nga dispozitat ligjore të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.

Gjithashtu, edhe në rastin SIKUR gjithçka më sipër do të ishte korrekte sipas kërkesave të ligjit dhe ky shtetas do të kishte respektuar ligjin në njoftimin e subjekteve dhe që regjistrimi do të mbante emrin e tij e jo të institutit *** , edhe në këtë rast akuzesi i dëmtuar *** duhet të vërtetonte dëmin pasuror dhe jo pasuror që i paskërkish ardhur nga publikimi i kësaj sekuence filmike për informacion publik si edhe duhej të vërtetonte përfitimet pasurore të personit që e kishtë përdorur por gjatë hetimit gjyqësor asnjë nga këto pretendime të kërkuarit nuk u provua.

Ligji nr.9380/2005 garanton mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që marrin pjesë në veprimtari krijuese, prodhuese, tregtare ose çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, shkencore apo artistike, (nenet 1 dhe 2 të Ligjit).

Subjekt i së drejtës së autorit, është personi që krijon një vepër letrare, shkencore apo artistike, (neni 5). Ndërsa objekt i të drejtës së autorit është produkti/vepra e punës krijuese të mendjes së njeriut, ku përfshihet midis të tjerave edhe krijimet vizuale, (neni 7/d).

Vepër konsiderohet edhe një produkt i cili krijohet nga kompozimi i disa veprave, (vepër e prejardhur), (neni 8). Në nenin 9/dh të Ligjit nr.9380/2005 parashikohet midis të tjerave se nuk janë objekt i të drejtës së autorit dhe nuk gëzojnë mbrojtje, lajmet dhe informacioni i shtypit. Në këtë Ligj përcaktohen të drejtat vetjake jopasurore dhe ato pasurore të autorëve të veprave, mjetet e mbrojtjes së këtyre të drejtave, organet kompetente që garantojnë mbrojtjen dhe rivendosjen e tyre, procedurat përkatëse për ankimet administrative si dhe të drejtën e subjekteve për t'iu drejtuar gjykatës duke kërkuar shpërblimin përkatës dhe ndalimin e cënimit të së drejtave.

Në nenin 28 të Ligjit nr.9380/2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të etj”parashikohet shprehimisht rastet kur riprodhimi i veprës së autorit pa qëllime fitimi, mund të kryhet pa leje apo autorizim të tij. Në këtë dispozitë shprehimisht thuhet: “1. Riprodhimi i veprës ose i një pjese të saj mund të bëhet pa autorizimin e autorit

a të titullarit të të drejtës së autorit, në rastin e dhënies në huapërdorje të veprave nga institucionet publike, që disponojnë kopje origjinale të ligjshme të veprës, vetëm për reklamë kulturore, por pa qëllim fitimi.

2. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni bëjnë:

a) partiturat muzikore dhe operistike;

b) fonogramet dhe videogramet, që përmbajnë vepra muzikore, kinematografike ose audiovizuale, sekuenca filmike, me ose pa zë, me kusht që të kenë kaluar 18 muaj nga ushtrimi i të drejtës së shpërndarjes për herë të parë.

3. Si huapërdorje, në këtë rast, nënkuptohen:

a) fotokopje të veprës origjinale, me përjashtim të partiturave operistike dhe muzikore;

b) fonograme dhe videograme që përmbajnë vepra muzikore, kinematografike, audiovizuale ose sekuenca të pamjeve filmike, me ose pa zë, me kusht që të kenë kaluar 18 muaj nga ushtrimi i të drejtës së shpërndarjes për herë të parë.

*Në rastin konkret instituti *** është një institut italian publik dhe serioz në punën e tij që sic theksuam më sipër nuk pirateron të drejtat e autorit.*

Kërkuesi duhet të jepte këto shpjegime gjatë hetimit gjyqësor të cilat nuk arriti t'i jepte dhe provonte me fakte dhe prova mbi pretendimet kryesore të tij si:

*Kujt i përkiste autorësia CD-Audio Regjistrimit pamje filmike, institutit *** apo atij vetë dhe pse dhe si instituti *** paska një video-rregjistrim të tillë?*

*Këto të drejta të autorit të videogramit të xhiruar në vitin 1991 i përkasin vetë personit *** apo këto të drejta janë të institutit ***?*

*A e kishte informuar më përpara shtetasi *** institutin *** për këtë fakt? A kishte instituti *** të drejta mbi këtë spot? A kishte paditur apo informuar institutin *** për këtë fakt dhe nëse po, cila kishte qenë përgjigjja e këtij instituti?*

*Cila ishte marrëdhënia e institutit *** dhe RTSH për këtë videogram? Cili kishte qenë roli i institutit Italian *** me RTSH, *** në këtë veprimtari dhe kujt i përket realisht autorësia e kësaj vepre? Dhe pse? Nëse po, në çfarë mënyrë e provonte këtë fakt?*

*Si përfituar i akuzuari *** nëse gjithmonë do të merrnim të mirëqena gjithcka që kishte sjellë kërkuesi janë sipas formës së kërkërkuar nga ligji, dhe në se PO, çfarë paskërkish përfituar dhe paskësish qenë masa që paskërkish përfituar, i akuzuari? Si edhe çfarë dëmi pasuror i paskërkish shkaktuar akuzuesit të dëmtuar?*

*A legjitimohej kërkuesi të ngrinte padi për këtë kërkesë kur në CD-Audio regjistrim pamje filmike këto pamje i përkisnin institutit Italian ***?*

*Sa më sipër kërkuesi në gjatë hetimit gjyqësor kishte detyrimin për t'i dhënë përgjigje duke provuar me prova dhe fakte të gjithë pretendimet e tij ndaj shtetasit të akuzuar *** të cilat rezultuan të ishin thelbësore në zgjidhjen e konfliktit mes palëve si dhe në aplikimin e drejtë të Ligjit nr.9380/2005. Vetëm pasi të ishte hetuar, provuar dhe vërtetuar plotësisht me fakte dhe prova autorësia e videogramit të vitit 1991 të institutit *** , të RTSH dhe *** nga ana e kërkuesit, atëherë ky i fundit duhet të kalonte gjatë hetimit gjyqësor në analizën tjetër konkretisht nëse ishim apo jo përpara kushteve të nenit 28/1 të Ligjit 9380/2005, (Riprodhimi i veprës ose i një pjese të saj mund të bëhet pa autorizimin e autorit a të titullarit të të drejtës së autorit, që disponojnë kopje origjinale të ligjshme të veprës, por pa qëllim fitimi). Të cilën as këtë analizë juridike nuk realizoi gjatë hetimit gjyqësor.*

C. Nga ana prokurorit * u kerkua rrezimi i kerkeses, pasi ne rastin konkret videogrami nuk eshte nje veper artistike, veper letrare, veper muzikore dhe as nje veper shkencore. Videogrami nuk mund te jete nje veper arstitike pasi **nuk eshte nje krijim original i nje personi**. Ai eshte nje filmim i xhiruar me kamera, qe ka fiksuar momentin kur eshte rrezuar busti i Enver Hoxhes.**

D. *Gjykata çmon se i akuzuari ***, duhet te deklarohet i pafajshem per vepren penale te “Riprodhimit pa te drejte te vepres se tjetrit”, te parashikuar nga neni 149 i K.Penal. Pretendimet e bera nga ana e te akuzuarit se kerkuesi ***, per mungese te legjitimet aktiv per ngritjen e kesaj kerkese, “duke qenë se CD- Audio Regjistrim pamje filmike permbante logon e institutit italian *** i cili është një institut i mirënjohur ndërkombëtar shumë serioz dhe që nuk ka si praktikë të punës së tij piraterimin e të drejtave të autorit dhe që këto të drejta në faqen zyrtare të saj i lejon të transmetohen falas për qëllime publike dhe informimi. Pra, i vetmi kërkuar që do të mund të depozitonte këtë kërkesë për gjykim ndaj shtetasit *** duhej të ishte instituti italian *** dhe jo kërkuar ***,” nga ana e kesaj Gjykate nuk merren ne konsiderate, pasi i akuzuari *** ka ngaterruar legjitimitetin aktiv, pra qe eshte i demtuari akuzues kerkuesi *** (qe ai e ka kete legjitimitet), me ate pasivin qe ne rastin konkret eshte i akuzuari **, apo qe mund te ishte instituti italian *** (i pretenduar nga i akuzuari) dhe qe eshte disponim i lire i te demtuarit akuzues ne rastin konkret .*

*Ky konstatim vjen pasi, pretendohet nga ana e te demtuarit akuzueses ***, se në datën *** ora *** minuta, në faqen e tij personale, i akuzuari *** në rrjetin social Facebook, me të dhënat e ***, ka publikuar një video me përshkrimin ‘Fjalimi i Azem Hajdarit pas atentatit të parë në Parlament’ me pamje nga rrëzimi i bustit të Enverit të realizuara nga z ***, pa lejën dhe miratimin e tij.Shtetasi ***, ka transmetuar në facebook veprën e tjetrit, nëpërmjet postimit ka patur 4 mijë e 300 vizitorë, 240 pëlqime, 50 shpërndarje*

Neni 149 i K.Penal, parashikon se: “Riprodhimi teresisht ose pjeserisht i vepres letrare, muzikore, artistike ose shkencore qe i perket nje tjetri ose perdorimi i tyre pa pelqimin e autorit, kur kane shkelur te drejtat vetjake e pasurore te tij, perben kundravajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjer ne dy vjet”.

Ky nen mbron marredheniet juridike te vendosura per te mbrojtur paprekshmerine e te drejtes se autorit nga veprimet ose mos veprimet kriminale. Nga ana objektive vepra penale kryhet me ane te riprodhimit, te vepres qe do te thote ribotim me cdo lloj mjeti, fotokopjim riprodhim me dore etj., te vepres letrare, muzikore, arstistike ose shkencore.

*Gjate gjykimit u provua se me certifikaten e regjistrimit dt.31.07.2007, nga Zyra Shqiptare per te Drejtat e Autorit, eshte certifikuar rregjistrimi i se drejtes se autorit ***, per vepren “Videogram “20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes”.*

*Nga ana e te demtuarit akuzues u pretendua se transmetimi i kesaj vepre nga ana e ***, pa lejen e tij si autor, perben vepren penale te parashikuar nga neni 149 i K.Penal.*

*Gjykata veren, se neni 149 i K.Penal merr ne mbrojtje nje kategori te caktuar te veprave te autorit, qe jane **veprat letrare, muzikore, artistike ose shkencore.***

Ne nenin 4, te Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”, jepen perkufizime te vepres artistike, vepres letrare, vepres muzikore, vepres arkitekturore, vepres teatrore, vepres dramatike, vizatim, gravure, videogramit, skulptures, etj.

Videogrami, objekt i ketij gjykimi, eshte evidente qe nuk eshte as veper letrare, as muzikore dhe as shkencore.

Kategoria tjetere qe merret ne mbrojtje nga neni 149 i K.Penal ka te beje me riprodhimin teresisht ose pjeserisht te vepres artistike.

Ne nenin 4, pika 33, te Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”, percaktohet se: “...Veper arstistike eshte cdo krijim origjinal, intelektual i nje personi fizik i materializuar, pavaresisht nga forma a menyra e te shprehurit, qe ka per qellim te preke ndjesite e njeriut”.

*Pra veper artistike do te quhet cdo krijim origjinal, intelektual i nje personi fizik, ndersa “Videogrami “20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes”, objekt i ketij gjykimi eshte videogram, filmim i nje momenti historik dhe jo krijim origjinal i te demtuarit akuzues ***.*

Nisur nga sa me siper, Gjykata duke u nisur nga perkufizimi qe i ben ligji vepres artistike cmon se “*Videogram 20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes*”, nuk eshte veper artistike, pasi perkufizimi i videogramit percaktohet, po ne nenin 4 te te Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005, pika 33 e ketij ligji, sipas te cilit: “..videogram nenkupton mjedisin ku eshte fiksuar nje veper audiovizuale e materializuar me ose pa kolone zanore, qe lejon percjelljen e riprodhimit e vepres...”.

Gjykata cmon se transmetimi i ketij videogrami nga ana e *** nuk perben veper penale ne veshtrim te nenit 149 te K.penal, per sa kohe qe ne kete nen nuk permendet videogrami ne kategorine e veprave te autoreve te mbrojtura nga ligji penal. Pra ligjvenesit ka percaktuar vetem kater kategori veprash te autoreve qe merren ne mbrojtje nga ligji penal (*letrare, muzikore, artistike ose shkencore*) dhe videogrami nuk ben pjese ne keto vepra.

Por duke qene se videogrami ben pjese ne kategorine e veprave te autorit qe mbrohen nga ligji nr.9380 date 28.04.2005 “*Per te drejten e autorit dhe te drejttar te tjera te lidhura me te*”, z.***, nese e çmon, mund ti drejtohet gjykates civile duke paditur palen e akuzuar dhe nese ne ate gjykim vertetohet se ***, **ka** shkelur te drejten e tij te autorit duke transmetuar videogramen per te cilen z. *** eshte autor, Gjykata cmon se ky shtetas ***mund te pergjigjet vetem civilisht per kete shkelje*** te te drejtes se autorit por jo penalisht.

Duke qene se fakti penal i pretenduar nuk perben veper penale, kjo Gjykate nuk e çmon te pergjigjet pretendimeve te bera nga ana e te akuzuarit *** ne lidhje me provat dhe vlefshmerine e tyre te pretenduara qe nuk jane ne perputhje me ligjin, pasi ato ju neneshtuan shqyrtimit gjyqesor dhe u vleresuan ne dhenien e vendimit perfundimtar, vetem ato prova qe jane ne formen e kerkuar nga ligji.

Per sa me siper Gjykata çmon se nga provat e administruara rezulton se nuk ndodhemi perpara vepres penale te “*Riprodhim pa te drejte te vepres se tjetrit*”, parashikuar nga neni 149 te K.Penal, ***per shkak se fakti (transmetimi i videogrames) nuk perben veper penale*** dhe ne keto kushte bazuar ne nenin 388/b te K.Pr.Penale, i akuzuari ***, duhet te deklarohet i pafajshem per sa akuzohet.

Sa u tha me siper u provua me spjegimet e paleve dhe provat shkresore te administruara ne dosje.

PER KETO ARSY E

Gjykata, ne baze te neneve 379, 380,384, 388/b, 3493 dhe 398 te K.Pr.Penale

V E N D O S I

1. Deklarimin e pafajshem te te akuzuarit *** per vepren penale te “***Riprodhimit te padrejte te vepres se tjetrit***” te parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal.
2. Shpenzimet procedurale (gjyqesore te perlllogaritura dhe ato te mbrojtjes me avokat ne shumen prej *** (***) leke i ngarkohen te demtuarit - akuzues ***.
3. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes.

U shpall ne Tirane sot, me 16.03.2016.

SEKRETARE

-VALTIDA RIBAJ-

GJYQTARI

-BEDRI QORI-